



RAPORTI I PROGRESIT PËR MARRËVESHJEN KOMPAKTE

QERSHOR 2014

BORDI I PËRBASHKËT BASHKËRENDUES PËR
SUNDIM TË LIGJIT

Parathënie

Një vit e gjysmë pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kompakte (Kompaktit) në mes të Kosovës, PSBE/Zyrës së BE-së dhe EULEX Kosova, ky Raport i Progresit të Kompaktit shënon një moment të rëndësishëm: përfundimin e mandatit aktual të EULEX Kosova në qershor 2014 dhe fillimin marrëveshjes së re, të miratuar nga Kuvendi i Kosovës, për vazhdimin e prezencës së Misionit në Kosovë deri në qershor 2016. Përmbyllja e paradokohshme e negociatave për Marrëveshjen e Stabilizim-Asocimit është po ashtu një e arritur e rëndësishme për Kosovën.

Me vendimin për mandatin e EULEX-it, Kosova e ka nënvizuar mbështetjen e saj të vazhduar e të plotë për Misionin, si dhe përkushtimin e saj për forcimin e sundimit të ligjit në Kosovë. Gjatë javëve në vazhdim do të bëhen hapa të rëndësishëm për tranzicionin e mandatit të EULEX-it, për shembull, të gjitha institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë do të kryesohen nga zyrtarë kosovarë. Këto ndryshime do të jenë të rëndësishme, por asgjë nuk ka ndryshuar përkitazi me përkushtimin tonë: organizimi i institucioneve të qëndrueshme, llogaridhënese, të pavarura dhe shumetnike të sundimit të ligjit, të lira prej ndërhyrjeve politike dhe të cilat u përmbahen standardeve të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane. Këto janë synimet për të cilat ne angazhohemi bashkërisht që t'i arrijmë gjatë viteve në vijim.

Raporti shërben si bazë për dy vitet e ardhshme. Gjatë muajve të fundit një numër i objektivave janë arritur. Institucionet e Kosovës janë forcuar dhe janë më të afta në adresimin e sfidave të sundimit të ligjit. Në veçanti, progresi i arritur në zbatimin e marrëveshjeve të ndryshme brenda kornizës së dialogut të lehtësuar nga BE-ja ka ndihmuar në inkurajimin e institucioneve. Disa prej tyre janë: është krijuar Komanda e re Rajonale Veri e Policisë së Kosovës, e përforcuar nga ish-policët e MUP-it të integruar në sistemin e Kosovës. Mbledhja e të hyrave doganore ka filluar në dy pikë-kalimet në veri të Kosovës dhe palët janë pajtuar për lokacionin e pikë-kalimeve të përhershme. Një numër prej 12,391 kopjesh të certifikuara të Librave të Regjistrat Civil u janë dorëzuar autoriteteve të Kosovës, të cilat do të kontribuojnë në krijimin e një Shërbimi Civil të besueshëm në Kosovë.

Ne, po ashtu, vlerësuam se puna është larg prej përfundimit. Një numër i përkushtimeve tona ende mbeten për t'u plotësuar. Në Bordin e Përbashkët për Bashkërendimin e Sundimit të Ligjit, ne e kemi rishikuar progresin e arritur dhe jemi pajtuar për një numër hapash që duhet të ndërmerren me qëllim të plotësimit të ambicieve. Ne i kemi miratuar udhërrëfyesit për përmirësimin e kapaciteteve të institucioneve vendëse. Ato kanë mbetur prapa kornizave kohore të pajtuara, kryesisht për shkak të mungesës së burimeve njerëzore dhe financiare. Ne jemi të përkushtuar për adresimin e këtyre mangësive gjatë muajve në vijim.

Ka ardhur koha për institucionet e Kosovës që të marrin përgjegjësi të shtuara për çështjet e ndërlikuara dhe të ndjeshme të sundimit të ligjit, duke përfshirë adresimin e ndërhyrjeve politike në fushën e sundimit të ligjit. Por, ato nuk do të jenë vetëm. PSBE/Zyra e BE-së dhe EULEX-i janë të gatshëm për t'i mbështetur institucionet gjatë gjithë këtij procesi.

Përfaqësuesi Special i BE-së në Kosovë/
Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë
Samuel Žbogar

Shefi i Misionit
të EULEX-it në Kosovë
Bernd Borchardt

Zëvendës Kryeministri i Kosovës/
Ministri i Drejtësisë
Hajredin Kuçi



Hyrja dhe historiku

BORDI I PËRBASHKËT PËR BASHKËRENDIMIN E SUNDIMIT TË LIGJIT VAZHDOI TË DREJTOJË ZBATIMIN

Bordi i Përbashkët Bashkërendues për Sundimin e Ligjit (BPBSL), një trup i bashkë-kryesuar nga Zëvendës Kryeministri i Kosovës/Ministri i Drejtësisë, Përfaqësuesi Special i BE-së/Shefi i Zyrës së BE-së në Kosovë dhe Shefi i Misionit EULEX, paraqet forumin kryesor për diskutimin e temave të sundimit të ligjit dhe për mbikëqyrjen e zbatimit të Kompaktit të nënshkruar më 9 nëntor 2012. Kompakti e mbështet Kosovën në proceset e integritimit në BE, të cilat e përfshijnë Dialogun për Liberalizimin e Vizave, Dialogun e Procesit të Stabilizim-Asocimit dhe Dialogun e Strukturuar për Sundimin e Ligjit.



Në mënyrë që BPBSL-së t'i mundësohet që ta bëjë një shqyrtim të rregullt të progresit, përgatitet një pasqyrë e rregullt e aktiviteteve dhe arritjeve e cila është në formë të Mekanizmit Përcjellës të Kompaktit (MPK), i cili i përfshin treguesit konkret. Në bazë të gjetjeve të veta, BPBSL ka qenë në gjendje të identifikojë vonesat ose dobësitë e zbatimit të tij. Përmes BPBSL-së, institucionet e sundimit të ligjit në Kosovë janë inkurajuar që t'i intensifikojnë përpjekjet e tyre për të siguruar që veprimet relevante nga Kompakti të kthehen prapë në binarë.

Periodha e raportimit ishte shënuar me një ngadalësim të pjesshëm të zbatimit të marrëveshjes së Kompaktit, veçanërisht lidhur me udhërrëfyesit e dakorduar, e që mbetet një faktor i rëndësishëm i cili i mundëson EULEX-it që të mos ketë angazhim të shtuar në disa fusha të caktuara.

Me qëllim që Paneli i dytë për Ankesa në Agjencinë Kosovare të Pronës dhe Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme (DHPGJS) për çështjet e privatizimit të jenë plotësisht funksionale, të dyja institucionet kanë pasur nevojë për kuadro shtesë. Procesi i rekrutimit, me gjithë vonesën, është duke vazhduar dhe pritet që të finalizohet në javët në vazhdim. Nevojitet punë e mëtejme, në veçanti për hapat e dakorduar për avancimin e funksionimit të DHPGJS-së, si bie fjala, rekrutimin e gjyqtarëve vendës dhe të stafit mbështetës. Kjo, së bashku me masat tashmë të zbatuara, si rregullat e miratuara për klasifikimin dhe ndarjen e lëndëve, të cilat përfundimisht do të ndihmojnë në rritjen e shkallës së zgjidhjes së lëndëve në DHPGJS.

Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve e Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë vazhdon të mos ketë kuadro të mjaftueshëm dhe pajisje adekuate. Pritet që vonesat në sigurimin e ndarjes së burimeve adekuate (armëve të zjarrit dhe municionit), trajnimeve specifike për mbështetjen e përcjelljes së të burgosurve në veri të Kosovës, do të tejkalohen në një të ardhme të afërt. SHKC, pas një marrëveshje me Policinë e Kosovës, e ka shprehur gatishmërinë që të marr përsipër detyrat e përcjelljes në veri. Pritet që një Memorandum i Mirëkuptimit për mbështetjen e përcjelljes së të burgosurve në veri do të nënshkruhet së shpejti, duke i mundësuar EULEX-it që gradualisht të tërhiqet nga funksionet ekzekutive të mbetura në këtë fushë në një të ardhme të parashikueshme.

Tensionet ndërmjet shqiptarëve dhe serbëve të Kosovës dominojnë më shumë në veri, në rajonin e Mitrovicës, sesa në pjesët tjera të Kosovës. Policia e Kosovës (PK) aktualisht i ka zhvilluar Procedurat Standarde të Operimit (PSO) dhe aktivitetet trajnuese për raportimin e krimeve ndëretnike.

Përderisa shqetësimi i dëshmitarëve vazhdon të jetë sfidë për Kosovën, progresi në fushën e mbrojtjes së dëshmitarëve mund të vërehet, kurse Drejtoria për Mbrojtjen e Dëshmitarëve në Kosovë është duke shkuar drejt arritjes së kapaciteteve të plota funksionale. Udhëzimet e nevojshme administrative dhe memorandumet e mirëkuptimeve janë përgatitur me autoritetet relevante shtetërore, si dhe janë nënshkruar me disa shtete partnere. Puna e mëtejme është duke vazhduar në krijimin e parakushteve të nevojshme për DMD të PK-së që të fillohet me marrjen e rasteve.

Në fushën e ndjeshme të krimeve të luftës, EULEX-i dhe Kosova kanë filluar të punojnë në themelimin e një sektori në PSRK dhe në PK, si dhe në arritjen e marrëveshjeve me shtetet fqinje dhe institucionet ndërkombëtare.

Planet për avancimin e performancës së Departamentit të Mjekësisë Ligjore janë formuluar dhe miratuar, duke i përfshirë masat si: angazhimi i antropologëve nga mjekësia ligjore vendase, auditimi i raporteve mjeko-ligjore të papërfunduara dhe përfshirja e ekipit të zhvarrimit në organikën e DML-së. Të gjitha masat e parapara varen nga shndërrimi i këtij Departamenti në një Agjenci të Pavarur, një vendim ky për të cilin kërkohen ndryshime ligjore për të cilat Qeveria e Kosovës ka shprehur gatishmërinë për t'i çuar përpara.

Në përgjithësi, institucionet përkatëse të sundimit të ligjit kanë pasur vështirësi për t'i siguruar burimet e nevojshme njerëzore dhe financiare me qëllim të arritjes së synimeve të përcaktuara dhe arritjen e afateve kohore të miratuara në udhërrëfyes. BPBSL ka diskutuar për këtë në takimin e fundit dhe e ka vlerësuar përkushtimin e përtërirë të Qeverisë së Kosovës për të pajisur me burime institucionet përkatëse.

BPBSL, po ashtu, e ka miratuar një tabelë të standardeve anti-korrupsion për ta përcjellë progresin në zbatimin e politikave ekzistuese kundër korrupsionit. Ai e ka themeluar një grup punues për ta plotësuar tabelën me të dhëna konkrete dhe që ta përditësojë atë rregullisht. BPBSL do ta vazhdojë rishikimin e procesit në këtë fushë në baza të rregullta.

Në bazë të diskutimeve për kornizën e Dialogut të Strukturuar të Sundimit të Ligjit në janar 2014, BPBSL kishte filluar diskutimin për mënyrën e adresimit të sfidave të perceptuara të ndërhyrjes politike në fushën e sundimit të ligjit. Këtu përfshihen marrja me deklaratat e papërshtatshme lidhur me procedurat gjyqësore në vijim e sipër, që e vë në pikëpyetje pavarësinë e gjyqësorit, si dhe mangësitë legislative, mbrojtjen e pamjaftueshme të institucioneve të sundimit të ligjit ndaj ndërhyrjeve potenciale dhe mungesën e burimeve njerëzore dhe të burimeve tjera. BPBSL ka për qëllim që të pajtohen së shpejti për një sërë masash për adresimin e kësaj çështje. Iniciativat si këto, të bashkuara me udhërrëfyesit dhe prioritetet tjera të identifikuara brenda kontekstit të procesit të përafrimit me BE-në, duke e përfshirë Dialogun e Strukturuar të Sundimit të Ligjit, Liberalizimin e Vizave dhe vlerësimin nga Raporti i Progresit, do të sigurojnë shtyllën kryesore për punën e BPBSL gjatë dy viteve të ardhshme.

★ ★ ★

Në bazë të gjetjeve nga Mekanizmi Përcjellës i Kompaktit, raporti në vijim e vlerëson punën e BPBSL për herë të dytë, duke i theksuar arritjet e shënuara përmes përpjekjeve të bashkërenduara në mes të institucioneve të Kosovës dhe familjes së BE-së gjatë periudhës së raportimit (shtator 2013 deri prill 2014). Ky raport synon që të kontribuojë për transparencën dhe llogaridhënien e përgjithshme të procesit të zbatimit të Kompaktit, duke e njoftuar publikun me informacionet më të reja për atë që është realizuar deri më tani dhe se çfarë mbetet për t'u realizuar.

Kompakti i përcakton 24 Veprime, secili prej tyre i përvijon aktivitetet dhe fushëveprimin e bashkëpunimit në mes të Kosovës dhe EULEX Kosova. Pjesët në vazhdim ofrojnë një pasqyrë të përmbledhur të gjendjes aktuale të zbatimit të Kompaktit.

Ky raport nuk ka për qëllim që të paraqes një rishikim të tërësishëm të asistencës të cilën e ofron BE-ja për Kosovën. BE-ja i përdor një vister veglash të ndryshme për ta mbështetur rrugëtimin e Kosovës në BE, duke përfshirë në masë të shtuar asistencën për institucionet e sundimit të ligjit përmes Instrumentit të Para-Anëtarësimit (IPA), duke i përfshirë edhe një numër projektsh të Binjakëzimit dhe të TAIEX-it. Kombinimi në një shkallë të gjerë i asistencës së BE-së është paraparë që ta maksimizojë perspektivën e Kosovës në përmbushjen e kriterëve që dalin nga Dialogu i Strukturuar për Sundimin e Ligjit, Dialogu për Liberalizimin e Vizave dhe Dialogu për Procesin e Stabilizim-Asocimit. Kompakti synon ta bëjë konsolidimin e të gjitha kriterëve në një strukturë të detyrave vepruese dhe udhërrëfyesë të cilat mund të vazhdojnë në nivelin teknik të BPBSL.

Ky raport, i cili fokusohet në zbatimin e Kompaktit, duhet të lexohet në lidhje me dokumentet tjera të cilat e standardizojnë progresin e institucioneve të sundimit të ligjit në Kosovë në rrugën e tyre drejt të qenit të pavarur, institucione shumetnike të sundimit të ligjit të lira prej ndërhyrjeve politike, të cilat i respektojnë të drejtat e njeriut dhe i përmbahen standardeve të njohura ndërkombëtarisht dhe praktikave më të mira evropiane. Hollësi të mëtejme lidhur me zbatimin e Veprimeve të Kompaktit janë siguruar përmes Mekanizmit Përcjellës të Kompaktit, i cili përditësohet rregullisht dhe mund të gjendet në faqen e internetit të EULEX-it.

1. POLICIA dhe DOGANA



Objektivat

- Të zhvillohet Njësia për Operacione Speciale (NJOs), me fokus në llogaridhënie, shqetësimet e pakicave etnike për sigurinë dhe bashkëpunimi efektiv me palët me interes;
- Të sigurohet realizimi i të gjitha masave të ndërtimit institucional për Inspektoratin e Policisë së Kosovës (IPK), si dhe pajtueshmërinë e plotë të PK-së me rekomandimet nga IPK;
- Të zbatohet më tej Plani Strategjik për Sistemet e Teknologjive të Informimit dhe Komunikimit (PSSTIK) të PK;
- Të avancohet shtylla administrative e PK;
- Të forcohen kapacitetet e PK për detyrat policore në komunitet;
- Të ndihmohet aftësimi i stafit të lartë drejtues të PK për t'u marrë me rastet e krimeve ndëretnike;
- Të përmirësohet bashkëpunimi ndërinstitucional në mes të PK dhe Prokurorisë së Shtetit (PSH);

- Të vendoset skema për mbrojtjen e dëshmitarëve (SMD) për Kosovën në kuadër të Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (DMD);
- Të nxitet partneriteti në mes të PK dhe Njesisë së Inteligjencës Financiare (NJIF) me qëllim të luftimit efikas të krimeve ekonomike;
- Të avancohen aftësitë e Doganës dhe Policisë Kufitare të Kosovës për menaxhimin e kufirit.

Aktivitetet dhe Rezultatet

Njësia për Operacione Speciale e Policisë së Kosovës:

Procesi i centralizimit të Njesisë për Operacione Speciale të Policisë së Kosovës (NJOS) ka bërë NJOS të jenë në Prishtinë dhe në pjesën jugore të Mitrovicës. Ky proces ka mundësuar arritjen e njërit prej synimeve të Kompartitit që është integrimi i plotë i të gjithë policëve të gjitha komuniteteve të NJSO së Mitrovicës në sistemin funksional të centralizuar të NJOS të PK. Për më tepër, Ekipi për Reagim të Shpejtë (ERSH), si njësi në mes të policisë dhe NJOS, e ka mandatin që të reagojë me operacione të rrezikut të mesëm dhe ajo është nën përgjegjësinë e drejtorëve rajonalë, në pajtim me decentralizimin e përgjithshëm të PK. Këto ekipe mund të kryejnë disa lloje të misioneve si, patrullime në lagje problematike, arrestime/paraburgime të kriminelëve të rrezikshëm dhe të kryejnë detyra në shkallë më të ulët të Operacioneve të Kontrollit të Trazirave dhe Turmës (KTT). Pas finalizimit të procesit të rekrutimit, numri i pjesëtarëve të ERSH në shtatë rajonet e Kosovës është planifikuar të jetë, si vijon: Prishtinë 30, Pejë 23, Gjilan 15, Ferizaj 15, Prizren 23, Mitrovicë pjesa jugore 15 dhe Mitrovicë në veri me 40 pjesëtarë.



Njësia e PK për Sigurimin e Objekteve të Trashëgimisë Fetare dhe Kulturore (NJSTFK) aktualisht ka staf të mjaftueshëm, me përbërje etnike të përzier dhe është duke i përmbushur detyrat e veta sipas planeve. Njësia numëron 204 policë (shqiptarë 72%, - serbë 16% - boshnjakë 7% - turq 4% dhe 1% tjerë). Proporcioni gjinor i njesisë është 6% femra dhe 94% meshkuj. NJSTFK e PK përkujdeset për sigurimin e 194 objekteve të trashëgimisë fetare dhe kulturore, në mesin e tyre janë 24 kisha ortodokse, të cilat janë nën mbrojtje me sigurim statik 24/7, duke përfshirë Patriarkanën e Pejës e cila i qe dorëzuar nën mbrojtje NJSTFK të PK në shtator 2013. KFOR-i vazhdon me praninë e vet statike në Manastirin e Deçanit.

Inspektorati Policor i Kosovës:

Në mënyrë që Inspektorati Policor i Kosovës (IPK) t'i arrijë standardet evropiane dhe ta krijojë një strukturë fleksibile për të reaguar më mirë ndaj kërkesave, në IPK janë realizuar disa ndryshime të brendshme, si: Udhëzimi Administrativ (UA) për Organizimin dhe Strukturimin e Brendshëm, i cili tashmë është kryer; rregullat nga ky UA janë duke u zbatuar nga IPK. Drejtorët tashmë janë caktuar dhe përmes një procesi të drejtë të përzgjedhjes janë përzgjedhur 10 prej gjithsej 14 shefave të divizioneve. Mirëpo, nuk ishte e mundur të bëhej përzgjedhja e të gjithë shefave të nevojshëm për shkak të mungesës së personelit i cili do t'i plotësonte kriteret e parapara për vendet e punës. Është vendosur një sistem për matjen e performancës, por ai duhet të rishikohet në pajtim me strukturën e re të IPK. Po ashtu, është duke u bërë rishikimi i mungesave të UA-ve. PSO-të për IPK, duke i përfshirë të gjitha detyrat dhe përgjegjësitë e departamenteve janë në proces e sipër. IPK nuk ka UA për procedurat e ankesave, meqë kjo nuk është e paraparë në Ligjin për IPK. Kjo çështje do të adresohet në PSO-të për IPK të cilat janë duke u përgatitur.

Të gjitha rekomandimet për hetime penale janë të miratuara; të gjithë policët që kanë qenë duke u hetuar ishin suspenduar sipas kërkesës.

Asnjë inspektim nuk është bërë gjatë kësaj periudhe të raportimit; Plani Vjetor i Inspektimit për 2014 është finalizuar dhe inspektimet do të fillojnë së shpejti. Planet për hapjen e një zyre të IPK në pjesën veriore të Kosovës janë duke u shqyrtuar.

Plani Strategjik për Sistemet e Teknologjive të Informimit dhe Komunikimit (PSSTIK) të PK:

Komponentë të ndryshëm të PSSTIK, të cilat e rregullojnë ruajtjen e informacionit për burimet njerëzore, financa dhe logjistike janë aktualisht në nivele të ndryshme të zbatimit; Megjithatë, është paraparë që zbatimi i plotë të arrihet nga muaji qershor 2014.

Shtylla administrative e PK:

Fokusi kryesor i bashkëpunimit në mes të PK dhe EULEX-it – përmes monitorimit të proceseve të tenderimit – për përmirësimin e procedurave administrative të PK ishte që shpenzimet, prokurimi dhe menaxhimi i autoparkut t'i përmbahen kornizës ligjore të zbatueshme. Për shembull, detajet procedurale, përbërja e duhur e

komisioneve dhe menaxhimi i drejtë i dokumenteve, janë shqyrtuar në hollësi. Shumica e këtyre procedurave janë në përputhje me ligjin, ndërsa të tjerat janë ende në fazën e diskutimit.

Mosfunksionimi i Organit Shqyrtues të Prokurimit (OSHP), për shkak se anëtarëve u ka skaduar mandati që nga gushti 2013, ka shkaktuar vonesa të mëdha të procedurave të prokurimit. Anëtarët e ri të OSHP janë emëruar në fund të muajit mars 2014 dhe Bordi posa ka filluar të funksionojë përsëri. Si pasojë e mosfunksionimit të tej-zgjatur të OSHP-së, një numër i tenderëve është dashur të anulohen për shkak të kalimit të afateve kohore. Kjo mund të ketë ndikim në shpenzimin e buxhetit dhe funksionalitetit të PK.

Policia në komunitet:

Këshillat Komunale për Siguri në Komunitet (KKSK) si organe konsultative të parapara me udhëzimet administrative të nxjerra nga Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, i kanë zhvilluar 284 takime në vitin 2013. PK ka marrë pjesë në 95% të këtyre takimeve. Pas zgjedhjeve lokale të mbajtura në fund të vitit 2013, të cilat sollën ndryshime në përbërjen e kuvendeve komunale dhe zyrat e kryetarëve të komunave, aktivitetet e KKSK rifilluan në 34 komuna (me përjashtim në pjesën veriore të Mitrovicës, Leposaviq, Zubin Potok dhe Zveçan), me qëllim të inkurajimit të zyrtarëve komunalë, PK-së, dhe shoqërisë civile për të punuar së bashku në çështjet e sigurisë lokale për rritjen e nivelit të sigurisë në komunitete.



Krimet ndëretnike:

Krimi ndëretnik bën pjesë në mesin e çështjeve më të ndjeshme në Kosovën e pas konfliktit. Meqenëse të dhënat e besueshme dhe strategjia e komunikimit pro-aktiv janë të rëndësishme, veçanërisht për zvogëlimin e frikës dhe zbutjes së tensioneve, synimi i Kompaktit është të prodhojë mekanizma dhe rregulla të cilat do ta trajtojnë krimin ndëretnik përmes sigurimit të mbledhjes së statistikave të besueshme. Procedurat Standarde të operimit (PSO) të PK dhe aktivitetet e trajnimit për raportimin e krimin ndëretnik janë duke u zhvilluar. Përkufizimet të cilat janë aktualisht në përdorim do të vlerësohen dhe harmonizohen për të siguruar përdorimin me konsistencë të terminologjisë për qëllime statistikore. Policia e Kosovës e përdor analizën e saj për raportet e shpejta si dhe për raportet statistikore mujore për vëzhgimin e rasteve dhe për informacionet statistikore për rastet ndëretnike. Puna e mëtejme lidhur me këtë çështje është duke u shtyrë përpara nga BPBSL.

Bashkëpunimi PK-PP:

Si pjesë e Projektit të binjakëzimit “Forcimi i Kapaciteteve për Hetimet Penale kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit” në prill 2014 janë organizuar disa punëtori për bashkëpunimin në mes të Policisë së Kosovës dhe Prokurorisë Publike (PP) në Kosovë. Në punëtori pjesëmarrës ishin përfaqësues të PK, prokurorisë, IPK, projektit të binjakëzimit dhe ekspertët e EULEX-it. Punëtoritë kishin për qëllim njohjen e pjesëmarrësve me rolet aktuale të Policisë së Kosovës dhe të prokurorisë në hetimin e krimeve dhe me modalitetet e bashkëpunimit. Janë kryer edhe vlerësimet për fushat të cilat kanë nevojë për përmirësim. Procedurat aktuale dhe strukturat menaxhuese të cilat e sigurojnë kornizën e bashkëpunimit në mes të PK-PP janë rishikuar, duke arritur në përfundimet për mbajtjen e takimeve mujore të menaxhmentit në nivel rajonal dhe nivel të shteteve. Ishte gjetur një mirëkuptim i përbashkët për nevojën e identifikimit të prokurorëve për raste të caktuara dhe t’u mundësohet atyre që të lidhen me njësitë policore përkatëse që në fazat e hershme të hetimit, veçanërisht në fushën e krimin të organizuar dhe korrupsionit. Trajnime të përbashkëta për PK dhe për një pjesë të prokurorisë ishin në mesin e masave të sugjeruara. Punëtoritë sigurojnë mundësi për diskutime joformale në mes të palëve të përfshira, të cilat do ta lehtësojnë bashkëpunimin e tyre.

Edhe pse marrëveshja për temat specifike mund të vlerësohet si e mirë dhe e kënaqshme, ekziston nevojë e mëtejshme që të zbatohet një bashkëpunim sistematik dhe praktik ndërmjet prokurorisë dhe Policisë së Kosovës në të gjitha nivelet. Kjo vlen në veçanti për nevojën që të ketë prokurorë të specializuar në fusha të caktuara të krimin të organizuar, krimin trans-nacional dhe korrupsionit. Puna policore e bazuar në inteligjencë (PBI), përfshirë ekipet hetuese pro-aktive (task forcat e përbëra nga shumë agjenci) dhe takimet për caktimin e detyrave dhe për bashkërendim me përfshirjen aktive të prokurorëve janë mënyra për të shkuar përpara në mbështetjen e përpjekjeve të bashkëpunimit të përmirësuar.

Skema për mbrojtjen e dëshmitarëve:

Projekti i financuar nga BE-ja “Mbrojtja e Dëshmitarëve në Luftën kundër Krimin të Organizuar dhe Terrorizmit II” (WINPRO II) është duke përparuar brenda afateve kohore paksa të vonuara. EULEX, WINPRO dhe PK janë në fazën përmblylëse të përfundimit të korigjimit të strukturës organizative të Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve të Policisë së Kosovës (DMDPK), përshkrimet e detyrave të punës për DMDPK, të legjislacionit sekondar

si edhe të Procedurave Standarde të Operimit (PSO). Udhëzimet Administrative tashmë janë aprovuar nga MPB. Disa prej PSO-ve të korigjuara janë duke u përpunuar nga Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës. Një Rregullore për Komisionin për Mbrojtjen e Dëshmitarëve është përfunduar dhe anëtarët e Komisionit janë emëruar. Janë nënshkruar memorandumet e mirëkuptimit ndërmjet PK-së dhe autoriteteve përkatëse shtetërore. Deri tani Policia e Kosovës i ka punësuar 13 pjesëtarë të trajnuar në Drejtorinë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve (DMD). Ata janë trajnuar në disa shtete të Ballkanit dhe të Evropës. Drejtorja e Policisë së Kosovës i ka dhënë vetura të policisë DMD, automjete të tjera priten nga WINPRO. Janë lidhur marrëveshje të përgjithshme për bashkëpunim dhe mbrojtje të dëshmitarëve me disa shtete evropiane. Ndonëse Drejtori i Drejtorisë për Mbrojtjen e Dëshmitarëve ka theksuar se njësisë e tij ishte e gatshme që të merret plotësisht me dëshmitarët deri më 1 mars 2014, DMDPK prapë se prapë do të ketë nevojë për ndihmë menaxherike dhe teknike nga EULEX-i dhe WINPRO II gjatë periudhës së paraparë të tranzicionit.

Partneriteti PK-NJIF:

Është shënuar përparim i konsiderueshëm drejt rezultateve të pritura. Memorandumi i Mirëkuptimit ndërmjet Policisë së Kosovës dhe Njesisë së Inteligjencës Financiare (NJIF) për këmbimin elektronik të informatave, i nënshkruar në shkurt 2013, është zbatuar plotësisht nga të dy palët. Deri më tani, NJIF e Kosovës i ka nënshkruar nëntë memorandume të mirëkuptimit me vendet partnere dhe është duke diskutuar me partnerë bashkëpunues shtesë. Gjatë prillit 2014, është zhvilluar një vlerësim në vendin e punës në NJIF të Kosovës nga tri shtete anëtare mbështetëse të Grupit Egmont. Ekipi vlerësues është impresionuar nga Departamenti i Analizave Financiare Hetuese dhe me punën e tij kundër pastrimit të parave/financimit të terrorizmit (KPP/KFT). Vizita solli deri te përfundimi se NJIF e Kosovës i plotëson standardet e Grupit Egmont dhe ekipi vlerësues rekomandoi që NJIF e Kosovës duhet të pranohet në Grupin Egmont. Është shënuar përparim lidhur me rekrutimin e stafit të nevojshëm të NJIF për plotësimin e nevojave funksionale. Prej numrit të paraparë prej gjithsej 20 pjesëtarëve të stafit, aktualisht janë 17 pjesëtarë të stafit. Për ta arritur numrin e plotë, është pranuar propozimi i Drejtorit të NJIF drejtuar Ministrit të Ekonomisë dhe të Financave për pranimin e tre analistëve të tjerë.

Janë mbajtur dy kurse trajnimi për të punësuarit e NJIF lidhur me: shfrytëzimin e duhur të PSO të re të Mbikëqyrjes së Pajtushmërisë (14/01/2014) dhe për inspektimet efektive të pajtushmërisë. Dy kurse të tjera trajnimi janë organizuar për PSO për Mbikëqyrjen e Pajtushmërisë; tri për sistemin goAML (zbatimin elektronik për analizat e NJIF); një për Kodin e ndryshuar të Procedurës Penale të Kosovës; një për legjislativën e Kosovës me rëndësi për Marrëveshjen për Stabilizim dhe Asociim; dhe një seminar për konfiskimin e pasurisë me titullin 'Përcjelli paratë'. Pavarësisht nga rëndësia e trajnimit adekuat për zyrtarët e NJIF, udhëheqja e njësisë është e vetëdijshme për rrezikun që stafi i specializuar të largohet për shkak të punëve më fitimprurëse, për shembull në sektorin bankar. NJIF Kosova i ka ndryshuar PSO-të e saj dhe rregulloret e brendshme sipas rekomandimeve të Task Forcës të Veprimit Financiar (TFVF).

Dogana e Kosovës dhe Policia Kufitare e Kosovës:

Plani Strategjik i Doganës së Kosovës (DK) për vitin 2013-15, i cili është pjesë kryesore e strategjisë së përgjithshme të punës së DK-së, ka parashikuar përfshirjen e një sistemi të vlerësimit. Ky sistem është menduar t'ju



ndihmojë Drejtorëve Rajonalë të DK-së që t'i menaxhojnë degët dhe stafin e tyre në mënyrë më efektive. Aktualisht, pjesa më e madhe e Drejtorëve Rajonalë të DK kanë profile të menaxhimit për t'ju ndihmuar në organizimin e punës së tyre dhe kryerjen e kontroleve të sigurisë së stafit, ndërsa vetëm disa kanë mbetur që ta përfundojnë këtë në të ardhmen e afërt. Drejtorët Rajonalë janë duke marrë mbështetje në lidhjen e shfrytëzimit të profileve të menaxhimit të degës me një nismë të re për të krijuar plane zhvillimore të Drejtorisë Rajonale.

Njësisë e DK për Auditim pas Zhdoganimit (APZH) e ka hartuar një plan të veprimit/auditimit për vitin 2014 – si pjesë e strategjisë së përgjithshme afariste të DK, e cila i parashikon 12 objektiva¹. Është parashikuar që të ketë më shumë punë të përbashkët me Administratën Tatimore të Kosovës (ATK), si edhe bashkëpunim më të mirë me sektorët e tjerë të DK, me Policinë e Kosovës (PK), Agjencinë Kosovare për Produkte Medicinale, institucionet ekonomike dhe financiare. Përfundimi i pozicionimit të zyrtarëve hetues nga ATK në Sektorin e DK për Zbatimin e Ligjit do t'i shtojë mundësitë për operacione të përbashkëta. Megjithatë, ndërtimi i kapaciteteve për Auditimin pas Zhdoganimit (APZH) kërkon përmirësime të mëtejme, andaj për këtë janë paraparë një numër i trajnimeve që do të kryhen nga Projekti i ardhshëm i Binjakëzimit.

Sektorin për të Drejta Pronësore Intelektuale dhe Industriale (DPII) ka paraqitur një raport vjetor për vitin 2013, në të cilin janë përvijuar të arriturat, por edhe problemet dhe sfidat me të cilat do të përballen më 2014 (dhe më pas). Njëra prej nismave kryesore është rritja e vetëdijesimit publik – si edhe informimi i opinionit të gjerë lidhur me kërcënimet ndaj shëndetit dhe sigurisë në lidhje me mallrat e falsifikuara dhe nën-standardet. Profilet e rrezikut janë vazhdimisht duke u përditësuar në sistemin doganor dhe zyrtarët e DK mund ta sigurojnë listën e personave të regjistruar që i mbajnë të drejtat. Shifrat e siguruara nga DPII i DK tregojnë përparim të qartë prej fillimit të punës së Sektorit më 2010. Megjithatë, duke e pasur parasysh që mbi 200 zyrtarë të DK janë trajnuar dhe kanë parë prezantime të një numri të mbajtësve të drejtave, numri i referimeve të DPII në selinë kryesore duhet të jetë shumë më i madh. Njësisë e DPII, e cila ishte e përbërë prej tre pjesëtarëve është zvogëluar në dy pjesëtarë për shkak të zbatimit të procedurave doganore të automatizuara dhe të veglave të reja të TI-së.

1. Në mesin e 12 objektivave, përqendrimi kryesor është në gjërat në vijim: vlerësimi, tekstilet, mallrat elektronike, pjesët e automjeteve, farmaceutikët dhe një fushatë më e madhe e Doganës për Bizneset.

Bordi Nacional Ekzekutiv për Menaxhimin e Integruar të Kufirit (MIK) e ka përfunduar një draft të Planit Zhvillimor për Qendrën Nacionale për Menaxhimin e Kufirit (QNMK). Përveç planit zhvillimor për QNMK, DK ka aktivizuar sërish linjën e posaçme telefonike kundër kontrabandës/kundër korrupsionit dhe çdo veprimtarie tjetër kundërligjore, e cila është e lidhur drejtpërdrejt me QNMK. Prej atëherë, kjo Qendër i ka pranuar 67 thirrje vetëm në prill 2014, ndërsa gjatë tërë vitit 2013 janë pranuar vetëm 80 thirrje. Ngjashëm, QNMK dhe ANP e kanë arritur një marrëveshje e cila i mundëson QNMK-së qasje të drejtpërdrejtë në kamerat e sigurisë së aeroportit, duke e rritur në këtë mënyrë kapacitetin mbikëqyrës të Qendrës dhe si rezultat sigurinë dhe lëvizjen e lirë të qytetarëve.

Procesi i demarkacionit të kufirit me Malin e zi, i cili parashikon po ashtu krijimin e Vendkalimeve të Përbashkëta Kufitare (VPK), është afër përfundimit dhe 88% e kufirit është përvijuar. 9km e mbetura që ishte planifikuar të përfundonin deri në fund të muajit prill 2014 janë vonuar për shkak të mosmarrëveshjeve lidhur me dokumentacionin që ka të bëjë me gjeografinë. Autoritetet e Ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë (IRJM) janë pajtuar për hapjen e një Zyre për Shkëmbimin e Informatave në vendkalimet kufitare Kosovë/IRJM.

Policia Kufitare e Kosovës (PKK) ka filluar zbatimin e Udhëzimit Administrativ për Zbatimin e Dispozitave Ndëshkuese të Ligjit për të Huajt. Në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANK), PKK i ka shqiptuar rreth 20 gjoba (prej 3,000 to 6,000 euro) për kompanitë e ndryshme ajrore të cilat kanë hipur në aeroplan udhëtarë pa dokumente të vlefshëm biometrike të udhëtimit ashtu siç parashikohet në Ligjin e ri për të Huajt. Udhëtarët pa dokument biometrik të udhëtimit nuk lejohen të hyjnë në Kosovë dhe kthehen në aeroportin prej nga kanë ardhur.

Hetimet e DK dhe ATK janë bashkëdyzuar në mënyrë të suksesshme dhe funksionojnë nën autoritetin e DK-së. Po ashtu, ekziston shkëmbimi i informative dhe përvojave të këtyre dy organizatave lidhur me rastet e përbashkëta. Lidhur me qasjen pro-aktive, duhet theksuar se nga fillimi i vitit 2014, DK dhe ATK e kanë ndryshuar qasjen e tyre ndaj rasteve me prioritet duke mundësuar kështu që hetimet të jenë pro-aktive në vend të vetëm aktive. Progresi nga kjo pritet të bëhet i dukshëm në gjysmën e dytë të vitit, kryesisht për shkak të aktakuzave të ngritura kundër të dyshuarve dhe sekuestrimit/konfiskimit të pasurisë së fituar në mënyrë të paligjshme.

Përkundër këtyre sfidave, në vendkalime të ndryshme kufitare, përfshirë ANP-në, janë vërejtur një numër i rasteve ku ka pasur rritje veçanërisht në zbulimin e narkotikëve. Në përgjithësi, zyrtarët e DK-së prirën të përqudrohen më tepër në operacionet gjatë hyrjes, të cilat mund të çojnë tek mungesa e inspektimeve për trafikun e drejtuar jashtë vendit.

Puna lidhur me ankesat e pazgjidhura për doganën dhe tatimet në kuadër të Bordit të Pavarur Shqyrtues (BPSH) po ecën mirë. BPSH gjatë punës së tij në kuadër të kompetencave që i ka është duke bërë përpjekje t'i përpunojë rastet e pazgjidhura. Deri në fund të muajit mars 2014 numri i ankesave të pazgjidhura është zvogëluar nga 943 (1 janar 2014) në 664 – dhe deri në fund të majit 2014 kjo shifër është zvogëluar në 435 raste të pazgjidhura.

Lëshimi i vizave në VKK nuk është në pajtim me Regjimin për Viza për të Huajt dhe me rekomandimet e Udhërfyesit për Liberalizimin e Vizave (ULV). Ligji i ri i Kosovës për të Huajt, i ndryshuar në pajtim me *acquis communautaire*, parashikon që viza hyrëse mund të lëshohet në VKK të caktuara në raste të jashtëzakonshme që konsiderohen si arsye të paparashikueshme dhe të domosdoshme për hyrje, interesa kombëtare madhore dhe për arsye humanitare. Megjithatë, pjesa më e madhe e rasteve të raportuara nuk kanë arsye të jashtëzakonshme që do ta arsyetonte lëshimin e vizës në VKK. Ka mungesë të vazhdueshme të udhëzimeve të qarta dhe të PSO të Policisë, të cilat ndikojnë në përmbushjen e përditshme të zyrtarëve të PKK që merren me këto çështje. Rojeve kufitare që punojnë në VKK u jepen informata kundërthënëse dhe nuk ka koordinim me institucionet e tjera (MPB dhe Ministria e Punëve të Jashtme (MPJ)) ose brenda strukturës së PKK.

2. DREJTËSIA



Objektivat

- Të përmirësohet Shërbimi Korrektues i Kosovës (SHKK)
- Të përforcohet kapaciteti i Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) dhe i Këshillit Prokurorial të Kosovës (KPK);
- Të plotësohet mandati i Agjencisë Kosovare të Pronës (AKP);
- Të përmirësohet performanca e Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS);
- Të mbështetet gjykimi i rasteve civile që kanë të bëjnë me pronën;
- Të zgjerohet bashkëpunimi ligjor ndërkombëtar (BLN).

Aktivitetet dhe rezultatet

Shërbimi Korrektues i Kosovës:

Pas vendosjes së themeleve për aftësimin e Shërbimit Korrektues të Kosovës (SHKK) që të kryejë inspektime të vetvetes duke e zbatuar Programin Ndërkombëtar të Standardeve të Auditimit (PNSA), SHKK ka arritur përparim nga faza planifikuese në fazën e zbatimit, gjatë së cilës periudhë të gjitha objektet janë vetë-audituar.



Inspektorati i Brendshëm (IB) i Ministrisë së Drejtësisë (MD) i ka përfunduar veprimtaritë e auditimit në të gjitha objektet korrektuese duke e shqyrtuar realizimin e rekomandimeve të bëra gjatë vitit 2011-2013. Është zbuluar që fushat më problematike ishin standardizimi i procedurave dhe i formularëve, të cilat pritet të finalizohen sa më shpejt, ndërsa çështjet tjera si masat e sigurisë, transferimi i të burgosurve dhe lejimi i pushimit të rregullt dhe pushimit të jashtëzakonshëm për të burgosurit duhet të adresohet edhe më tutje. Sipas IB, zgjidhja e shumicës së këtyre mangësive varet më tepër nga gatishmëria dhe aftësia e qendrës së SHKK-së dhe jo edhe aq shumë nga institucionet individuale korrektuese dhe drejtorët/stafi përkatës i tyre.

Duke u bazuar në gjetjet e tyre, IB ia ka paraqitur SHKK-së përmes MD-së rekomandimet lidhur me mënyrën e të siguruarit në të ardhmen që kërkesat për falje të plotësohen në pajtim me ligjin. Për më tepër, IB ka filluar inspektimin paraprak të personelit të SHKK-së gjatë të cilit ka gjetur se shumë të punësuar ishin ushtrues të detyrës për një kohë të gjatë. Për më tepër, IB po ashtu filloi ta bëjë shqyrtimin dhe inspektimin e mekanizmave

disiplinorë të burgosurve dhe të stafit në SHKK në nivel të qendrës. Me hyrjen në fuqi të Ligjit për Përmbartimin e Sanksioneve Penale (LPSP), Komisionet disiplinore të SHKK kanë filluar të funksionojnë në bazë të LPSP siç është e paraparë me nenin 230.

IB e ka hartuar planin e tij të punës për vitin 2014, ku fokusi kryesor është në gjetjet negative nga Raporti i Progresit 2013 i KE-së (korrupsioni, nepotizmi, kontrabanda, diskriminimi, shtimi i privilegjeve për disa të burgosur dhe efikasiteti i mekanizmit të ankesave të burgosurve), dhe është duke e zbatuar atë në përputhje me rrethanat. Për më tepër, inspektorëve të veçantë u janë caktuar detyra të posaçme dhe të identifikueshme që dalin nga Raporti i Progresit i KE-së. Prej hartimit të këtij plani, IB i ka kryer 18 inspektime. Ndonëse IB i ka ndërmarrë disa veprime përgatitore, aktualisht është duke e pritur përgjigjen e udhëheqjes së SHKK-së për ta krijuar një strategji të përbashkët lidhur me mënyrën e luftimit të këtyre fenomeneve të padëshiruara. Ngjashëm me këtë, Ministri i Drejtësisë e ka themeluar një task forcë, si dhe grupet profesionale të cilat janë duke punuar në lidhje me gjetjet dhe rekomandimet me qëllim të shmangies së zbrazëtirave të mundshme.

Fushë e vazhdueshme e shqetësimit është dobësia e dukshme në kontrollin e ushtruar nga SHKK-ja në të gjitha nivelet gjatë trajtimit të një numri të vogël të burgosurve dhe të paraburgosurve të profilit të lartë që janë politikisht aktivë, ku shumica prej të cilëve janë duke u përballur me ndjekje penale si pasojë e incidenteve që ndodhën në konfliktin 1998 – 1999, në veçanti në lidhje me transferimet e vazhdueshme nga paraburgimi në qëndrime të zgjata në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës (QKUK) në Prishtinë - ndonëse të gjitha lëvizjet e kryera për çështjen e hospitalizimit të personave të dënuar bëhen me rekomandimin e mjekut, ndërsa për të paraburgosurit njoftohet gjyqtari i rastit i cili edhe e jep lejen.



Në të gjitha objektet korrektuese dhe të paraburgimit është futur në përdorim sistemi i Raportimit të Informatave për Sigurinë (RIS). Është vendosur një program i monitorimit të sigurisë mbi zbatimin e praktikave më të mira në fushën e sigurisë. Programi shfrytëzon një listë të plotë të më shumë se 30 indikatorëve të sigurisë për t'i monitoruar objektet korrektuese dhe të paraburgimit. Bazuar në auditimet e kryera në një numër të institucioneve të korrektimit dhe paraburgimit, është vënë re një pajtueshmëri prej 80%; megjithatë, ka nevojë që puna që është bërë deri tani të plotësohet me trajnim shtesë të stafit. Për më tepër, SHKK e ka përgatitur Planin vjetor të trajnimeve që është i paraparë të realizohet gjatë vitit të ardhshëm. SHKK-së i është ofruar mbështetje e gjerë për t'iu ndihmuar atyre që ta vënë në punë Burgun e ri të Sigurisë së Lartë (BSL) në Podujevë. Ky objekt, pjesërisht i financuar nga BE-ja, do t'i jep SHKK-së mundësi që t'i sistemojë të burgosurit në një burg bashkëkohor dhe të sigurt dhe t'i plotësojë shumë prej "Praktikave më të mira evropiane" të kërkuara në këtë fushë të ligjit dhe rendit. Funkcionalizimi i BSL do t'i lehtësojë problemet në lidhje me të burgosurit me rrezikshmëri të lartë dhe të burgosurit e profilit të lartë të cilat po ndodhin aktualisht në burgjet tjera.

Prokurimi për SHKK-së mbetet shqetësim. Praktikën jo të mira të prokurimit ndikojnë në punën e përditshme të SHKK-së. Shumë procedura të rëndësishme të prokurimit kanë dështuar disa herë (p.sh. dhomat e sigurta në Spitalin e Prishtinës, automjetet për përcjellje, mirëmbajtja e automjeteve). Duhet urgjentisht të gjendet një zgjidhje e përshtatshme dhe e qëndrueshme për t'iu shmangur situatës ku komprometohet aftësia e funksionimit, parrezikshmëria dhe siguria.

Këshilli Gjyqësor i Kosovës dhe Këshilli Prokurorial i Kosovës:

Në mënyrë që t'i zbatojë plotësisht dispozitat e Ligjit për Gjykatat dhe Këshillin Gjyqësor të Kosovës (KGJK), KGJK-ja duhet t'i aprovojë më shumë se 40 rregullore dhe udhëzime. Deri më tani, KGJK i ka aprovuar dhe i ka zbatuar 13 rregullore. Ende duhet të hartohen dhe të aprovohen edhe 12 rregullore të tjera. Këshilli Prokurorial i Kosovës (KPK) duhet t'i ketë rreth 50 instrumente ligjore (rregullore dhe udhëzime) në mënyrë që t'i zbatojë plotësisht dispozitat e Ligjit për KPK-në dhe të Ligjit për Prokurorin e Shtetit. Numri i instrumenteve ligjore të aprovuara dhe të publikuara nga KPK-ja deri më tani është 40. KPK tani është duke u përqendruar në rregulloret të cilat janë me rëndësi thelbësore për zbatimin e reformës në sistemin e drejtësisë penale. Në bazë të "Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve", Komisioni i KGJK-së për Vlerësimin e Performancës së Gjyqtarëve i ka rekomanduar 75 gjyqtarë për riemërim të përhershëm. Vetëm një gjyqtar nuk është rekomanduar meqë ai nuk i ka respektuar vendimet e gjykatës të nxjerra kundër tij dhe në këtë mënyrë ka dëmtuar reputacionin e gjyqësorit të Kosovës. Në bazë të "Rregullores për Vlerësimin e Performancës së Prokurorëve" të publikuar në tetor 2013, Komisioni i KPK-së për Procesin e Vlerësimit të Performancës së Prokurorëve në janar 2014 ka vendosur që së pari ta vlerësojë punën e 22 prokurorëve gjatë mandatit të tyre fillestar dhe pastaj punën e 35 prokurorëve me mandat të përhershëm. Njësia për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve (NJSHP) është duke i ofruar ndihmë Komisionit të KPK-së lidhur me të gjitha dokumentet e nevojshme në mënyrë që ai ta kryejë punën e cila deri më tani po përparon sipas planit.

KGJK-ja është në procesin e finalizimit të procesit të rekrutimit për gjyqtarë për Gjykatën Supreme (2 pozita – brendshëm), Gjykata e Apelit (8 pozita – brendshëm) në pajtim me Rregulloren për Ngritjen në pozitë të gjyqtarëve, e miratuar nga KGJK më 7 prill 2014.



Më 21 mars 2014, KPK aprovoi "Rregulloren për Kriteret dhe Procedurat për Zgjedhjen dhe Propozimin për Emërimin e Kryeprokurorit të Shtetit" dhe filloi procesin e përzgjedhjes së Kryeprokurorit të Shtetit. Kriteret i plotësuan tetë kandidatë dhe i paraqitën formularët e vetë-vlerësimit dhe koncept dokumentet, ashtu siç parashihet në rregullore, dhe u intervistuan.

KGJK-ja aprovoi Strategjinë Nacionale për Zvogëlimin e Numrit të Rasteve të Pazgjidhura. Strategjia ofron një kornizë të përgjithshme dhe ua mundëson Gjykatave Themelore t'i zhvillojnë planet e tyre individuale të veprimit për ta trajtuar menaxhimin e lëndëve duke i marrë parasysh specifikat e secilës gjykatë. KGJK akoma ka nevojë të zhvillojë indikatorë të thjeshtë të performancës në mënyrë që ta masë përparimin e Gjykatave Themelore. Ato duhet të jenë pjesë e një sistemi unifikuar të raportimit që do t'ia mundësojë KGJK-së t'i mbledhë dhe t'i analizojë informatat nga Gjykatat Themelore.

Në prill 2014, KGJK aprovoi Planin Strategjik për gjyqësorin 2014 – 2019 i cili përbëhet nga pesë shtylla strategjike: 1) Krijimi i besimit dhe i mirëbesimit në sistemin gjyqësor; 2) Përmirësimi i administrimit të drejtësisë; 3) Zgjerimi i qasjes në drejtësi dhe i shërbimit për publikun; 4) Promovimi i besimit, profesionalizmit dhe mirësjelljes; dhe 5) Përmirësimi i objekteve të gjykatave dhe i teknologjisë. Plani Strategjik më tej përvijon planet e veprimit për të siguruar që do të arrihet secili qëllim. Plani është menduar të jetë një mjet i përditshëm i udhëheqjes për KGJK-në dhe një udhërrëfyes për drejtimin e gjyqësorit të Kosovës gjatë pesë vjetëve të ardhshëm. Ndonëse aprovimi i planit është një e arritur e rëndësishme, tani nevojiten përpjekje të konsiderueshme për zbatimin praktik dhe arritjen e objektivave strategjike.

Përmbushja e mandatit lidhur me Agjencinë Kosovare të Pronës:

Komisioni për Kërkesa Pronësore i Kosovës (KKPK) dhe Paneli i Ankesave i Gjykatës Supreme për Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), të cilat përbëhen nga stafi i Kosovës dhe i EULEX-it, ka vazhduar t'i zgjidhë kontestet e pazgjidhura të pronës private të paluajtshme, bujqësore, komerciale dhe banesore që janë rezultat i konfliktit të armatosur 1998-1999. Gjatë periudhës raportuese, janë mbajtur tri seanca të KKPK-së dhe është marrë vendim lidhur me 2,836 kërkesa (dhe palëve u janë lëshuar 2,879 vendime), duke i lënë që të vendosen vetëm

898 prej gjithsej 42,701 kërkesave. Deri më 30 prill 2014, Paneli për Ankesa i AKP-së i ka zgjidhur 536 ankesa kundër vendimeve të KKKP-së dhe 248 ankesa janë regjistruar. Prej këtyre 248 ankesave, në Panelin e Ankesave të Gjykatës Supreme janë dërguar për shqyrtim dosjet për 141 ankesa dhe dosjet për 107 ankesa ende nuk janë dërguar në Gjykatën Supreme. Duke e pasur parasysh kompleksitetin e vendimeve në fazën e fundit të punës së KKKP-së, i cili do të çojë tek gjasat më të mëdha për ankesa, BPSL u pajtua në fillim të vitit 2013 që të themelohet një Panel i dytë i Ankesave i AKP-së. Deri sa EULEX-i siguroi edhe dy gjyqtarë të tjerë deri në verën e vitit 2013, Kosova duhet ende që të emërojë gjyqtarin për të cilin është pajtuar dhe të rekrutojë staf ndihmës shtesë. Kjo ka ndodhur kryesisht për shkak të mungesës së burimeve financiare si edhe mungesës së kandidatëve me cilësi dhe përvojë të duhur profesionale. Është paraparë që prej marsit 2014 deri në qershor 2014, në bazë të sistemit mujor të alternimit, një gjyqtar i dytë vendas prej njësisë së gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës të caktohet ad interim në Panel që të jetë anëtar i panelit kur të jetë e nevojshme.



Më 11 prill, Parlamenti i Kosovës e ka ripërtërirë mandatin e komisionarit vendas në KKKP. Kjo ishte më rendësi thelbësore në mënyrë që KKKP-ja të arrinte të përmbyllte seancat e saj të fundit. Megjithatë, financimi i sekretariatit të AKP-ës përben shqetësim serioz, meqë paraqet kërcënim për përfundimin e mandatit të AKP-së.

Rritja e performancës së Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme:

Numri i rasteve që janë në pritje për t'u zgjidhur nga DHPGJS-ja është rritur në 16,126 gjatë muajit prill 2014. Përpos në një panel gjykimi, numri i rasteve të pazgjidhura në panelet tjera ka vazhduar të rritet. Posaçërisht paneli IV i cili kryesisht trajton rastet e likuidimit dhe paneli V i cili është përgjegjës për çështjet që ndërlidhen me Trepçen kanë shënuar një rritje të konsiderueshme të rasteve gjatë kohës së fundit. Numri i rasteve në panelin IV është rritur nga 762 raste të pazgjidhura sa ishin në mars 2014 në 1,306 raste të pazgjidhura në prill 2014 (duke e arritur numrin total prej 8425 rastesh), në anën tjetër numri i rasteve në panelin V, gjatë periudhës së njëjtte është rritur nga 132 në 216 raste (duke e rritur numrin e rasteve të pazgjidhura në 969). Numri i madh i rasteve nga lëmi i likuidimit ka të bëjë me kompleksitetin e tyre, numrin e madh prej qindra paditësish për secilin rast, rastet e të cilëve duhet trajtuar individualisht.

Shkalla e zgjidhjes së rasteve në DHPGJS mbetet e ulët në nivelin 11.52 %, gjë që konfirmon rritjen e vazhdueshme të rasteve të pazgjidhura. Shkalla e zgjidhjes së rasteve vështirë se do të rritet në rrethanat e tanishme. Në përgjithësi, cilësia joadekuade e padive dhe shkresave të parashtruara në DHPGJS i kontribuojnë vonesave në procedimin e rasteve. Një arsye e veçantë për rritjen e numrit të rasteve të pazgjidhura është edhe numri i pamjaftueshëm i gjykatësve në DHPGJS (numër ky i kufizuar me ligj në 20 gjykatës, tetë (8) nga të cilët janë të EULEX-it ndërsa 12 janë kosovarë) të cilët trajtojnë një numër të madh të rasteve të parashtruara në DHPGJS që nga janari 2012. Numri i vendeve të zbrazëta për gjykatës kosovar është rritur nga dy në tre, gjë e cila e ka rënduar edhe më shumë punën e DHPGJS-ës në trajtimin e numrit madh të rasteve. Për tri pozitat e lira është shpallur konkurs ku kanë konkurruar 13 persona, ndërsa përzgjedhja e tre kandidatëve është në proces e sipër.

Përkthimi, po ashtu, ka një trend brengosës, nga 2000 faqe për muaj sa ishin gjatë vitit të kaluar është rritur në 3500 faqe për muaj në vitin 2014. DHPGJS ende nuk ka një faqe funksionale të internetit. Megjithatë, është aprovuar kriteri për kategorizimin e rasteve i cili ka pasur një ndikim të mirë në ngarkesën e punës me raste.

Koha dhe burimet e nevojshme për përkthim si dhe performanca jo e kënaqshme nga ana e shkrimores së gjykatës (për stafin, organizimin dhe mbikëqyrjen e së cilës është përgjegjëse KGJK-ja) kanë ndikuar që të mos ketë rritje domethënëse të rezultateve të DHPGJS-ës pa rrezikuar cilësinë e vendimeve dhe aktgjykimeve të saj.



Gjykimi i rasteve civile pronësore:

Në mbështetje të gjyqësorit vendas në gjykimin e rasteve civile pronësore të shkallës së parë dhe në panelin e ankesave, gjykatësit e EULEX-it i kanë përfunduar 73 raste civile ndërmjet muajve qershor 2012 dhe mars 2014, të cilat raste karakterizoheshin nga kompleksiteti i tyre, ndjeshmëria, shumëllojshmëria dhe shtrija territoriale.

Gjatë gjashtë muajve të fundit (shtator 2013 – mars 2014) janë iniciuar 16 procedura të marra përsipër sipas kërkesës së palëve, gjyqësorit kosovar ose sipas caktimit të një gjykatësi të EULEX-it sipas detyrës zyrtare (ex officio). Prej tyre, 13 janë kryer përmes vendimeve për deklarata me shkrim të dorëzuara palëve dhe të përfunduara me 12 vendime për caktimin dhe një për mos caktimin e rasteve civile. Gjatë muajve shtator 2013 – mars 2014, gjykatësit e EULEX-it i kanë pranuar 41 ankesa civile.

Bashkëpunimi ligjor ndërkombëtar:

Buxheti i Departamentit për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar (DBLN) është rritur në krahasim me vitet e kaluara si pasojë e një numri në rritje të kërkesave me temë bashkëpunimin e ndërsjellë ligjor ndërkombëtar. DBLN-ja ofron ndihmë ligjore ndërkombëtare në lëmin penal dhe civil e po ashtu harton dhe negocion marrëveshje bilaterale në këtë fushë. Më qëllim të përmirësimit të zbatimit të këtyre marrëveshjeve, KGJK-ja dhe KPK-ja kanë caktua pika kontaktuese në secilën gjykatë dhe prokurori për t'i adresuar rastet që ndërlidhen me bashkëpunimin ligjor ndërkombëtar në lëndët penale. Caktimi i pikave kontaktuese ka për ta përmirësuar edhe më shumë punën e DBLN-ës. Në muajin shkurt, në DBLN është punësuar edhe një zyrtar ligjor. Në bazë të marrëveshjes teknike për ndihmë ligjore të ndërsjellë ndërmjet Ministrisë së Drejtësisë dhe EULEX-it, gjatë kësaj periudhe raportuese, EULEX-i i ka transmetuar 93 kërkesa dhe përgjigje të Kosovës ndaj shteteve që nuk e njohin pavarësinë (duke përfshirë Serbinë) dhe 90 kërkesa e përgjigje të shteteve që nuk e njohin pavarësinë (duke përfshirë Serbinë) ndaj Kosovës. Në kuadër të dialogut Prishtinë–Beograd të lehtësuar nga BE-ja (bazuar në procedurat për ndihmë ligjore të ndërsjellë ndërmjet Kosovës dhe Serbisë që nga 20 marsi 2013), nga muaji shtator 2013 deri në mes të muajit maj 2014 EULEX-i i ka transmetuar 855 kërkesa dhe përgjigje nga Kosova në Serbi dhe 756 kërkesa dhe përgjigje nga Serbia në Kosovë.

DBLN-ja duhet ta rrisë numrin e propozimeve për marrëveshje bilaterale, posaçërisht në rastet e çështjeve civile ku marrëveshje të tilla nuk ka fare (përpos mundësisë për një marrëveshje në të ardhmen me IRJM-në e cila është në fazën e përfundimit të negociatave). Duhet vlerësuar se, Kosova i ka finalizuar tri marrëveshje me Malin e Zi, ndërsa marrëveshja me Italinë për Transferimin e Personave të Dënuar pritet të finalizohet nga mesi i muajit qershor.

3. VERIU I KOSOVËS

Objektivat

- Të rivendos sundimin e ligjit në pjesën veriore të Kosovës;
- Të përmirësojë performancën e PK-së në atë rajon;
- Të përmirësojë standardet në qendrën e paraburgimit në Mitrovicë;
- Të fuqizojë shërbimet e regjistrimit civil në atë pjesë.

Aktiviteti dhe rezultatet

PK-ja në pjesën veriore të Kosovës:

Në pajtim me marrëveshjen e dialogut të 19 prillit, është themeluar një drejtori e re rajonale e policisë. Kapiteni Đuric ka vazhduar të udhëheq si Ushtrues i Drejtorit Rajonal, emërimi formal varet nga themelimi i Asociacioni të Komunave Serbe. Nën udhëheqjen e tij, Drejtoria Rajonale e Policisë është zhvilluar mjaft mirë. Në kuadër të PK-së janë integruar 288 ish pjesëtarë të MUP-it të Serbisë.

Stacioni policor në Mitrovicën e veriut ka pasur një rritje të shkallës së zgjidhjes së rasteve gjatë katër muajve të fundit afërsisht 90%.



Me qëllim të përmirësimit të perceptimit publik të PK-ës në veri dhe rritjes së besueshmërisë së komuniteteve lokale për të raportuar rastet e krimeve dhe shkeljeve në PK, janë ndërmarrë veprime specifike: të gjitha stacionet kanë të miratuara dhe diktuarat zonat e tyre të patrullimit dhe shpërndarjes në bazë të politikës së PK-së për punët policore në sektorë me njësi më të vogla të caktuara për patrullim gjatë intervenimit. Ky model i shpërndarjes është i orientuar në plotësimin e strategjive të punës policore të bazuar në inteligjencë dhe punës policore në komunitet ngase ekipet sektoriale janë në gjendje që të kryejnë detyrat e nevojshme që ndërlihen me këtë lloj qasjeje policore, detyra këto që kryesisht kërkojnë afërsi dhe familjarizim me komunitetin ku vepron ekipi.

PK-ja e ka marrë kryesimin e takimit të partneritetit për siguri në komunitetin (PSK), i cili takim më parë bashkë-kryesohej me EULEX-in ndërsa shërben si zëvendësim i përkohshëm i Këshillit të paraparë Komunal për Sigurinë në Komunitet. Zgjedhjet e fundit komunale kanë ofruar një mundësi për formimin e Komiteteve Lokale për Siguri (KLS)² në pajtim me ligjin, ndërsa puna është duke vazhduar në drejtim të formimit të këtyre komiteteve. Pjesëmarrja e PK-së në takimet e sigurisë që mbahen në komunë është 100%. PK-ja në veri ka vlerësuar të gjitha rastet e raportuara të cilat kanë elemente të krimit me motive politike dhe etnike (KMPE). Megjithatë, vetëm një rast është kualifikuar si KMPE (në shtator 2013) i cili ishte hetuar siç duhet duke rezultuar me një hetim të përbashkët ndërmjet EULEX-it dhe PK-së në veri.

Hapat e parë për të krijuar stafin e ERSH-it për veri ka rezultuar në paraqitjen e 43 kandidateve (pesë femra, shtatë Shqiptar dhe 36 Serb) të cilët janë duke u ndjekur trajnimin.

Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë:

Zbatimi i udhërrëfyesit të miratuar në nivelin e BPKSL-ës, që ka për qëllim t'ia mundësoj Qendrës së Paraburgimit në Mitrovicë (QPM) ta bëjë përcjelljen e të burgosurve në veri dhe jashtë tij, duke mundësuar kalimin e EULEX-it në detyrën e mbetur ekzekutive të mbështetjes në këtë fushë, ende nuk ka shënuar progres të kënaqshëm. SHKK-ja momentalisht nuk ka mundësi që të vejë në dispozicion burimet e aprovuara ngase ka mungesë të fondeve dhe mjeteve shtesë për përmbushjen e obligimeve që dalin nga udhërrëfyesi përkundër angazhimeve të mëdha të tyre për t'i arritur rezultatet e pritura të cilat do të përforcohen nga mbështetja e PK-së.



2. KLS-të në përgjithësi kanë për qëllim t'i përgjigjen instancave lokale të komuniteteve në Veri.

QPM-ja i ka 38 oficerë korrektues, ndërsa vlerësohet se nevojiten edhe 20 deri 25 oficerë shtesë në mënyrë QPM-ja të jetë plotësisht funksionale. Gjithashtu, numri në rritje i të burgosurve në QPM ka detyruar futjen në funksion të kateve shtesë të kësaj ndërtese; gjë e cila e dëshmon nevojën urgjente për staf shtesë. Çështja e mungesës së stafit përbën një shqetësim të qartë për funksionimin e përgjithshëm efikas të QPM-ës.

Përderisa dy grupe të oficerëve të NJPB-vë të QPM-ës kanë ndjekur një trajnim specifik për përcjelljen e të burgosurve, QPM-ja ende ka mungesë të armëve të zjarrit, municionit dhe trajnimeve specifike, nënshkrimin të një memorandumit zyrtar me PK-në dhe organizatat tjera përkatëse për sundim të ligjit në mbështetje të përcjelljes së të burgosurve.

Shërbimet e Agjencisë së Regjistrimit Civil në veri të Kosovës:

Në shkurt 2014, Agjencia e Kosovës për Regjistrim Civil (ARC) në kuadër të MPB-së ka kërkuar ndihmë nga EULEX-i për themelimin e zyrave që do të ofrojnë shërbimet e ARC-së (gjendja civile, regjistrimi civil, letërnjoftimet/pasaportat, patentë-shoferat dhe regjistrimi i veturave) në komunat veriore si Mitrovica Veriore, Zveçani, Laposaviqi dhe Zubin Potoku. Aktualisht, ARC-ja ofron shërbime për komunat veriore përmes zyrave të saj mbështetëse në Lagjen e Boshnjakëve, Lipa, Bistricë dhe Qabër (të vendosura në lokacione/fshatra me shumicë shqiptare ose popullatë jo Serbe).

ARC-ja ka themeluar një grup punues (duke përfshirë ekspertë të EULEX-it) për të vlerësuar nevojat dhe kërkesat për ofrimin e shërbimeve të ARC-së ndaj qytetarëve të komunave veriore. ARC-ja tanimë po pranon kërkesa të shumta nga qytetarë të atyre komunave, gjë që tregon interesimin për shërbimet e lartcekura. Puna e këtij grupi punues do të varet nga themelimi i administratave funksionale në komuna, emërimit të Drejtorit të Përgjithshëm të Administratës si dhe situatës së përgjithshme të sigurisë në Kosovën veriore.

4. ZBATIMI I DIALOGUT

Objektivat

- Të mbështesë institucionet e Kosovës në zbatimin e disa marrëveshjeve të arritura në dialogun ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, duke përfshirë:
- Regjistrimi civil;
- Liria e lëvizjes (LeL);
- Menaxhimi i Integruar i Kufirit (MIK);
- Kontestet kadastrale.

Aktivitet dhe rezultatet

Regjistrimi civil:

Kopjimi dhe certifikimi i regjistrave civil në Serbi, i realizuar me mbështetjen e EULEX-it dhe Zyrës së BE-së, ka përfunduar me sukses më 31 mars 2014. Në total, janë kopjuar, certifikuar dhe dorëzuar tek Agjencia e Regjistrimit Civil (ARC) e Kosovës 12,391 regjistra civil dhe fetar të lindjeve, martesave dhe vdekjeve.



Në pajtim me përgjegjësitë e tij, EULEX-i, përmes takimeve të Komisionit të Përbashkët për regjistrin civil, e ka nxitur dhe inkurajuar ARC-në që të vazhdojë me fazën e dytë të digjitalizimit të librave amzë. Ai përfshin shënimin e të dhënave dhe krijimin e lidhjes së plotë për sigurimin e të dhënave me Sistemin Qendror të Statusit Civil (SQSC) nga librat amzë ekzistues origjinalë, të kopjuar, të rikonstruktuar dhe të certifikuar.

Institucionet e Kosovës ende kanë për ta bërë organizimin e Agjencisë së re të Regjistrimit Civil të Kosovës në praktikë dhe t'i digjitalizojnë Librat Amzë në mënyrë që të krijohet një sistem i qëndrueshëm dhe i besueshëm i gjendjes civile i cili është faktor i rendësishëm në procesin e liberalizimit të vizave dhe mbi të gjitha për sundimin e ligjit në Kosovë.

Aktivitetet MMK të EULEX-it janë të orientuara drejt zbatimit të shfrytëzimit konstant dhe të rregullt të kopjeve të certifikuara në mënyrë që ta forcojë sistemin e regjistrimit civil në Kosovë përmes arritjes së mbajtjes së besueshme të dhënave dhe krijimit të dhënave të sakta dhe të sigurta personale të qytetarëve. Në këtë aspekt, EULEX-i ka filluar të kryejë vizita në terren nëpër komunat që i kanë marrë kopjet e certifikuara të librave amzë të mbajtura në Serbi. Këto vizita do ta vlerësojnë shfrytëzimin e kopjeve të certifikuara në aktivitetet e përditshme të zyrave komunale të gjendjes civile dhe si rezultat i vizitave ARC do të jetë në dijeni lidhur me fushat në të cilat nevojitet përforsim i politikave dhe i procedurave të saj.

Liria e lëvizjes:

Në pajtim me marrëveshjen e dialogut për lirinë e lëvizjes (LeL) qytetarët e Kosovës dhe Serbisë janë në gjendje të udhëtojnë lirshëm brenda dhe përmes territorit të njëra tjetrës vetëm më anë të letërnjoftimit ndërsa për fëmijë nën moshën 16 vjeç vetëm më një certifikatë të lindjes.

Sipas marrëveshjes për lirinë e lëvizjes, pronarët e veturave që banojnë në Kosovë lejohet t'i shfrytëzojnë vetëm targat e veturave RKS ose KS. Prej 1 nëntor të vitit 2011 QK/MPB e ka zgjatur politikën e regjistrimit të automjeteve me targat KS dhe ka përkrahur një politikë të re për regjistrimet e automjeteve ndërmjet 10 qershorit 1999 dhe 31 tetorit 2011 të ish-RFJ-së ose Serbisë, duke ua mundësuar shfrytëzuesve të këtyre automjeteve t'i regjistrojnë ato me tabela KS ose RKS. Megjithatë, ka mbetur të bëhet verifikimi i këtyre automjeteve nga ana e Interpolit dhe duhet të vazhdohet dhënia e tabelave të përkohshme të regjistrimit deri sa të bëhet verifikimi. Sa i përket veturave, diskutimet në lidhje me pranimin e ndërsjellë të sigurimit ndaj palëve të treta janë duke vazhduar.

Që nga 18 dhjetori 2011, MPB-ja ka aplikuar një politikë të re e cila ua mundëson qytetarëve të ndërrojnë ish-patentë shoferat e Serbisë të lëshura ndërmjet 10 qershorit 1999 dhe 31 tetorit 2011 me një patentë shoferi të Kosovës. Numri total i qytetarëve që kanë aplikuar për patentë shoferi është 10,320. Gjithashtu, ky vendim u lejon aplikuesve të shtojnë kategori tjera në patentë shoferin e tyre të ri të Kosovës, nëse ato i kanë marrë nga autoritetet serbe në Kosovë ndërmjet 10 qershorit 1999 dhe 31 tetorit 2011 apo, të njëjtat janë legalizuar nga autoritetet serbe jashtë territorit të Kosovës. Ky vendim do të mbetet në fuqi deri me 31 dhjetor 2014, që është afati i fundit për aplikim.

Menaxhimi i integruar i kufirit/kufirit administrativ:

Në pajtim me marrëveshjen e MIK-ut (Menaxhimi i Integruar i Kufirit), gjashtë pikat e përkohshme të kalimit vazhdojnë të funksionojnë pa ndonjë problem të madh. Sistemi i Menaxhimit të Kufirit (SMK) është tërësisht funksional nëpër PK. Shkëmbimi i informatave ndërmjet dy administratave doganore, duke përdorur Sistemin e Shkëmbimit Sistemik Elektronik (SSHSE), ka filluar në nëntor 2013. Departamenti i Përgjithshëm për Zgjerim i Komisionit Evropian është zotuar se do ta vazhdojë mbështetjen e tij për projektin SSHSE edhe pas skadimit të tanishëm të kontratës për mirëmbajtje në qershor 2014. Kjo do ta sigurojë qëndrueshmërinë e lidhjes së SSHSE-s ndërmjet dy shërbimeve doganore të Kosovës dhe Serbisë. Është arritur një marrëveshje për pozitën gjeografike të gjashtë PK-vë të përhershme.



Kontestet kadastrale:

Zbatimi i marrëveshjes kadastrale, që ka për qëllim mbrojtjen e të drejtave të njerëzve që kanë padi legjitime pronësore, varet shumë nga aprovimi i ligjit për themelimin e Agjencisë Kosovare për Krahasimin dhe Verifikimin e Pronës (AKKVP) si pasardhëse e AKP-së. Me 27 mars, Parlamenti i Kosovës ka miratuar në lexim të parë projektligjin për AKKVP-në, e cila në vetvete ngërthen mandatin e vjetër të AKP-së që ka bërë me paditë/kërkesat pronësore që kanë pasuar si rezultat i konfliktit dhe mandatin e ri të AKKVP-ës për trajtimin e kontesteve që ndërlidhen me regjistrat kadastrale. Kur ky ligj të jetë në fuqi, mund të sigurohet fondi përkatës për AKKVP. Ligji i ri duhet të dorëzohet tek Komisioni Funkcional dhe Komisioni i Përhershëm i Parlamentit për shqyrtimin e tij pas zgjedhjeve të qershorit.



Migrimi

EULEX-i do të vazhdojë ta monitorojë dhe mbështesë zbatimin e Ligjit për të Huajt (Ligji nr.04/L-219). MPB/DSHAM është agjencia përgjegjëse qeveritare e cila merret me të gjitha llojet e të huajve, këtu përfshihet po ashtu monitorimi dhe mbështetja e zbatimit të regjimit aktual të vizave i cili ka filluar më 1 korrik 2013 dhe ende është në fazën provuese. Migrimi, i rregullt dhe i parregullt, është një fushë shumë e rëndësishme për të gjitha Shtetet Anëtare kur të përqendrohen në mbrojtjen dhe sigurinë e kufijve të jashtëm të BE-së. Një nevojë e tillë jetike është shprehur qartë në udhërrëfyesin për viza, blloku 2.

Lista e akronimeve dhe shkurtesave

UA	Udhëzim Administrativ
KSHP	Kundër Shpërlarjes së Parave
PV	Plani i Veprimit
SADHD	Sistemi i Automatizuar i të Dhënave Doganore
PKK	Pikë Kalimi Kufitar
SMK	Sistemi i Menaxhimit të Kufirit
VK	Veprimet Kompakte
PK	Pikë Kalimi
ARC	Agjencia e Regjistrimit Civil
LRC	Librat e Regjistrimit Civil
KTT	Kontrollimi i Turmave dhe Trazirave
MPK	Mekanizmi Përcjellës i Kompaktit
FLKT	Financimi i Luftës kundër Terrorizmit
DP	Drejtori i Përgjithshëm
DML	Departamenti i Mjekësisë Ligjore
DBLN	Departamenti për Bashkëpunim Ligjor Ndërkombëtar
LV	Leja e Vozitjes
DMD	Drejtorja për Mbrojtjen e Dëshmitarëve
KE	Komisioni Evropian
BE	Bashkimi Evropian
EULEX	Misioni i Bashkimit Evropian për Sundim të Ligjit
PSBE	Përfaqësuesi Special i Bashkimit Evropian
TFVF	Task Forca për Veprim Financiar
NJIF	Njësia e Inteligjencës Financiare
LeL	Liria e Lëvizjes
IRJM	Ish Republika Jugosllave e Maqedonisë

MIK	Menaxhimi i Integruar i Kufirit	MPBS	Ministria e Punëve të Brendshme të Serbisë
PSSTIK	Plani Strategjik për Sistemet e Teknologjive të Informimit dhe Komunikimit	QKMK	Qendra Kombëtare për Menaxhim të Kufirit
IB	Inspektorati i Brendshëm	KMPE	Krimet më Motive Politike dhe Etnike
DPII	Të Drejtat Pronësore Intelektuale dhe Industriale	NJPB	Njësia për Përcjelljen e të Burgosurve
BLN	Bashkëpunimi Ligjor Ndërkombëtar	APZH	Auditimi pas Zhdoganimit
DPBI	Detyrat Policore të bazuara në Inteligjencë	ANP	Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës
OPSH	Organi i Pavarur Shqyrtues	IPK	Inspektorati Policor i Kosovës
PSNA	Programi i Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit	NJSHPP	Njësia për Shqyrtimin e Performancës së Prokurorëve
BPKSL	Bordi i Përbashkët Koordinues për Sundimin e Ligjit	PP	Prokuroria Publike
PKK	Policia Kufitare e Kosovës	OSHP	Organi Shqyrtues i Prokurimit
DK	Dogana e Kosovës	ERSH	Ekipe për Reagim të Shpejtë
SHKK	Shërbimi Korrektues i Kosovës	LTFK	Lokacione të Trashëgimisë Fetare dhe Kulturore
KFOR	Forca e Kosovës	SIL	Sundimi i Ligjit
KGJK	Këshilli Gjyqësor i Kosovës	DHPGJS	Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme
IGJK	Instituti Gjyqësor i Kosovës	SHSEDH	Shkëmbimi Sistematik Elektronik i të Dhënave
PK	Policia e Kosovës	RIS	Raportimi i Informatave të Sigurisë
AKP	Agjencia Kosovare e Pronës	PSO	Procedura Standarde e Operimit
KPK	Këshilli Prokurorial i Kosovës	NJSV	Njësia Speciale e Veprimit
KKPK	Komisioni i Kërkesave Pronësore të Kosovës	PSRK	Prokuroria Speciale e Kosovës
AKKVP	Agjencia Kosovare për Krahasim dhe Verifikim të Pronës	ATK	Administrata Tatimore e Kosovës
DPKMD	Drejtoria e Policisë së Kosovës për Mbrojtjen e Dëshmitarëve	ULV	Udhërrëfyesi për Liberalizimin e Vizave
KLSK	Komisionet Lokale të Sigurisë në Komunitet	MDLKRT	Mbrojtja e Dëshmitarëve në Luftë kundër Krimeve të Rënda dhe Terrorizmit
KKSK	Këshillat Komunal të Sigurisë në Komunitet	SMD	Skema e Mbrojtjes së Dëshmitarëve
QPM	Qendra e Paraburgimit në Mitrovicë		
MPJ	Ministria e Punëve të Jashtme		
MMK	Monitorimi, Mentorimi dhe Këshillimi		
MPB	Ministria e Punëve të Brendshme		
MD	Ministria e Drejtësisë		
MM	Memorandumi i Mirëkuptimit		

A 3D graphic on a blue grid background. It features three upward-pointing arrows: a central yellow one and two white ones on either side. In the background, there is a target symbol with concentric circles. The arrows appear to be rising from a curved white base.

www.twitter.com/eulexkosovo
www.facebook.com/eulexkosovo
www.youtube.com/eulexkosovo